

20151544436

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZIONIN SHTETËROR

Neni 1

Në Ligjin për revizionin shtetëror (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 145/10, 12/14 dhe 43/14), në nenin 39 paragrafi (1), në fjalinë hyrëse fjalët “3.000 euro deri” shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së llogaritur për personin juridik-subjekti i revizionit do t’i shqiptohet për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik-subjekti i revizionit.

Neni 2

Në nenin 39-a në paragrafët (1) dhe (2) fjalët “4.000 deri” shlyhen.

Neni 3

Neni 41 ndryshohet si vijon:

“Për kundërvajtjet e caktuara me këtë ligj procedure për kundërvajtje mban dhe sanksione për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”

Neni 4

Pas nenit 41 shtohet nen i ri 41-a si vijon:

Neni 41-a

Përlllogaritja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.